



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:002723
Datë: 11.11.2024
Numri i dokumentit: 06431101

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florid Hasku, me bashkëpunëtoren profesionale Gresa Haxhiavdyli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit D. Ll. nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, Rr. "Fehmi Agani" Hy-25/4 Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti: Pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 800.00 euro, jashtë seancës, më 11 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit D. Ll. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit së lartcekur, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga 01.01.2020 e deri me datë 30.09.2022, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 637.59 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 04.01.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, në shumën prej 162.41 euro.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datën 04.01.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësi është i punësuar tek e paditura në SHFMU “Ganimete Terbeshi” në fshatin Ponoshec Komuna e Gjakovës . Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësit. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditësi ka paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar që të i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 05.09.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditësit nuk i takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi që Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ka shtuar se paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit të inflacionit pasi që në rast të shfaqjes së tij nuk godet vetëm një sektor të punësuarve si në rastin konkret sektorin e arsimit, por e godet tërë aparatit shtetëror. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Ganimete Terbeshi” fshatin Ponoshec Komuna e Gjakovës . Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës

bazë të paditësit është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes së inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2020 deri në vitin 2022 sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën janar-dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2020 ishte 421.00 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 10.10 euro, apo 0.84 euro për muaj ($421 * 0.2\% * 12 = 10.10$).
- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.40%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte

421.84 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 172.11 euro, apo 14.34 euro për muaj ($421.84 * 3.4\% * 12 = 172.11$).

- Për periudhën janar-shtator 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.60%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 436.18 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 9 mujore në total të jetë 455.38 euro, apo 50.60 euro për muaj ($436.18 * 11.6\% * 9 = 455.38$).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.01.2020 e deri me datë 30.09.2022 në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Pretendimin tjetër të të paditurës lidhur me atë se inflacioni godet tërë aparatit shtetëror e jo vetëm sektorin e arsimit, gjykata e konsideron si të parëndësishëm, për arsye se çështja e

përfshirjes së inflacionit në pagën e punëtorëve të arsimit është e rregulluar me KKAK, andaj është irelevantë se kushte goditet nga inflacioni, për atë kohë sa e drejta e paditësit për ta kërkuar këtë kriter të kompensimit rrjedh nga dispozitat e kontratës kolektive të lartcekur.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, gjykata gjeti se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, dhe atë vetëm për periudhën nga data 01.01.2018 e deri me datën 31.12.2019, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësja padinë e ka paraqitur me datë 04.01.2023, pra pas afatit prej tre (3) viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës, për periudhën e lartcekur.

Sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës në lartësi prej 162.41 euro, gjykata të njëjtën e refuzoi për shkak se për një pjesë kemi parashkrim të kërkesës të elaboruar si më lartë, e po ashtu paditësi në padi, nuk ka prezantuar prova materiale për të vërtetuar këtë lartësi të kërkesës, sipas detyrimit të përcaktuar me nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. E për më tepër, gjykata përlllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga viti 2020, duke shtuar normën e inflacionit vit për vit deri në vitin 2022 (*shtimi dinarik*), për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me ç' rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore) si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2023:002723, më 11 nëntor 2024

Gj y q t a r i

Florid Hasku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.